



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR ”

Konsultim publik : *Banoret e Nj. Administrative Ana e Malit*

Data : *15.10.2021*

Ora : *15.00*

Vendi: *Gjimnazi Oblikë*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 33, nga të cilat 7 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Per draft projekt planin buxhetor afatmesem 2022-2024 të bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës : Kryetare e bashkisë znj. Voltana Ademi, Administrator i Nj. Administrative z. Arben Ceni, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadija, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Drejtor i Drejtorise se Bujqesise Alban Sekja, Drejtor i Drejtorise Ekonomike të Arsimit Zj. Aulida Anamali, përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e bashkisë dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtruan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon:

I; ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. Z. Skender Taipi, Drejtor shkolle “Qazim Mehja” kërkoi:

- a. Shkollat në përgjithësi janë mirë. Kemi pas probleme në shkollën e Zuesit por është zgjidhur. Janë riparuar dhe janë lyer ambientet e shkollës.

- b. Shkollat lyhen rrallë, përveç koridoreve. Ne kërkojmë një zgjidhje. Të shihet mundësia që lysterja e shkollës të bëhet më shpesh.
- c. Problematike e madhe është mungesa e një kompjuteri. Nuk kemi bojë printer. Nuk është planifikuar bojë kompjuteri në një shkollë.nuk kemi bazë kancelarie. Interneti është në kushte shumë të mira.
- d. Në kopshtin e Oblikës është problem mungesa e një sanitareje, pasi pastrimin duhet ta bëjnë vetë edukatoret.
- e. Energjia elektrike është lidhur në mënyre të jashtëligjshme, tek kopshti Oblike.
- f. Të lidhet ujësjellësi me kopshtin. Kemi nevojë për një hidraulik qe realizojë lidhjen.
- g. Nje nga problemet që kemi në shkollë është dhe zëvendësimi i llampa që kanë nevojë.
- h. Transporti është zgjidhur për nxënësit dhe mësuesit.

2. Z.Arben Ceni, administrator i njësisë Ana eMalit.

- a. Shkollave në përgjithësi jemi përpjekur që tu shërbejmë. Klasat e të gjithë shkollave janë lyster.

3. Znj.Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë

- a. Iu është dërguar të gjithë drejtorive të shkollave një skedë, ku secila drejtori plotëson nevojat që kanë shkollat.
- b. Lidhur me nevojat për kompjuter, bashkia nuk e ka tagër për të plotësuar këto nevoja, por do të mundohemi që ti adresojmë këto nevoja në mënyrë që ti japim një zgjidhje këtij problemi.
- c. Lidhur me nevojën për një sanitare, do ta vlerësojmë situaten në mënyrë që ti japim një zgjidhje kësaj nevoje.

4. Znj.Xhemalije Taipi

- a. Kemi mungesë uji në kopësht. Tek hyrja e kopshtit duhen bërë kanalizimet sepse në periudhën e dimrit është e pamundur që të kalohet.

5. Znj.Aulida Anamali: Nisur nga problematikat që u ngritën informoj që:

- b. Lysterja e ambjenteve është bërë në shkolla.
- c. Plotësimi i nevojave për kompjuter, bazë kancelarike, bojë printer,bojë kompjuteri nuk është në tagrin e bashkisë që ti plotësojë.
- d. Nevojat për elektricitet i kemi plotësuar.
- e. Nevojen për një sanitare në kopësht duhet ta vlerësojmë si kërkesë.

6. Znj. Brisela Kadija, Kryetare e këshillit bashkiak

- a. Të shikohet mundësia e planifikimit që të realizohet sovatimi i shkollës së gjimnazit Oblikë, sepse po shikoj që ambjentet e shkollës kan plasaritje nga tërmeti.

II: MENAXHIMI I MBETJEVE

Znj.Voltana Ademi: - Realizojmë prej gjashtë vitesh shërbimin e pastrimit në territorin e Nj.Administrative Ana e Malit. Çfarë kemi nevojë që të bëhet më mirë? A kemi nevojë për shtim konteinerësh dhe ku? A kemi nevojë shtim frekuence për pastrimin e njësisë tuaj dhe ku?

1. **Z.Arben Ceni, administrator Njësisë Ana e Malit:** Është përmirësuar ndjeshëm shërbimi i pastrimit. Janë shtuar konteinerët ne Velinaj, në Garuc, në lagjen Goricë fshati Muriqan. Kemi bërë kërkesë për shtim pika grumbullimi mbetjesh dhe shtim konteinerësh në fshatin Obot, pasi kemi gjetur dhe vendin ku do të vendosen.

2. Qytetar

a. Në lagjen Xhaferraj duhet të shtohen pikat grumbullimit të mbetjeve dhe të bëhet shtimi i kontinjerëve.

3. **Znj.Voltana Ademi:** - Po shikojmë mundësinë e mbledhjes së mbetjeve derë më derë, duke duke vlerësuar heqjen e konteinerëve nga pikat e grumbullimit të mbetjeve. Si e vlerësoni këtë iniciative, si dhe a mendoni se ju shërben kjo mënyrë në përmirësimin e shërbimit?

4. Z.Ali Çeliku

b. Është një mendim shumë i mirë. Të shikohet mundësia e realizimit të kësaj mënyre por pa hequr konteinerët nga pikat e grumbullimit të mbetjeve.

5. Znj.Jona Leqejza, anëtare e Këshillit Bashkiak

c. Ndërkohë që po vija në këtë takim, në dy krahët e rrugëve konstatova që kishte problem me mbetjet. Kjo ndodh prej papërgjegjshmërisë së banorëve sepse nuk hidhen mbeturinat në vendin e caktuar. Kërkoj që të rritet inspektimi dhe të merren masa administrative(Gjoha) për shkelësit.

6. Z.Xhevdet Kuti, banor

d. Në fshatin Alimetaj janë problem mbetjet. Hidhen mbeturinat nga fermerët tek ura. Të shikohet mundësia a pastrimit të kanalit.

7. Znj. Voltana Ademi

e. Kanalin e kemi pastruar disa herë. Duhet që njerëzit të sensibilizohen që mos të hedhin mbetje. Gjithësecili nga ne duhet të kontribuojë që të mbajë pastër ambientin.

8. Kryetar i fshatit Muriqan

a. Koshat e mbeturinave pastrohen, kemi problem sepse gjatë peridhës së verës automjetet që kalojnë kufirin në drejtim të Shkodrës hedhin mbeturina.

- b. Propozim për zgjidhje: Të shikohet mundësia e punësimit të dy puntorëve sezonal që të realizojnë pastrimin gjatë kësaj periudhe.

9. Z. Mirsada Mandija, anëtare e Këshillit Bashkiak

- c. Të shikohet mundësia që kanalet të pastrohen. Të merren masa për fermerët që ndotin ambjentin.

10. z.Arben Ceni

- a. Nuk bllokohen rrugët nga mbetjet e fermerëve. Problemin më të madh fshati Oblikë e ka përse i përket nodtjes së ambjentit nga banorët e pa përgjegjshëm. Duhet bërë sensibilizim i banorëve ose të vendosen tabela në pika të nxehta përse i përket mbetjeve për moshedhje të mbeturinave.

III: SHERBIMET PËR KOMUNITETIN

1. z. Arjan Isufi

- b. Varrezat e Oblikës janë të pasistemuara dhe pa rrugë. Të shikohet mundësia e ndërhyrjes sepse është shumë e nevojshme.

IV: NDRICIMI RRUGOR

2. z. Arjan Isufi

- c. Kërkoj që në hyrje të fshatit Oblikë shtohen më shumë ndriçues

Prioritet për ndriçim

3. Qytetarët

- a. 1.Rruga nacionale nga ura e Bunës-Muriqan 25-30 ndriçues
- b. 2.Rruga Xhaferaj
- c. 3.Nga dogana deri tek fshati që të qon në Shtuf
- d. 4.Lagja Xhakej
- e. 5.Lagja.Kalldricë

- 4. **Z. Hilmi Sakti, Kryetar i Këshillit të Qarkut:** Ju bëj thirrje që të gjithë ju që jeni present këtu, të kërkonit atë që është më thëlbësore sepse është e pamundur që të realizohen të gjitha çfarë ju kërkonit.

V: SHERBIMI i KULLIMIT

5. **Z.Greta Bardeli, deputete e Qarkut Shkodër:-** Një ndër problematikat kryesore në Nj.A.Ana e Malit janë përmytjet. Pyetja që shtroj është; Ku jemi me fazën e dëmshpërblimit nga përmytjet dhe pse nuk vazhdon si proces?
6. **Znj. Voltana Ademi-** Në Bashkinë Shkodër kemi realizuar fazën e vlerësimit të dëmëve. Është duke u vlerësuar nga ana e këshillit bashkiak.
7. **Znj.Brisela Kadija:** - Ka pasur problem për interpretimin ligjor. Ka dalë ligji i ri për Emergjencat Civile por nuk është mbështetur me aktet plotësuese gjë që na pengon për vazhdimin e kësaj procedure.
8. **Z.Fatmir Meti:** Me intereson problem i ullitjes dhe i kullimit. A keni nje plan për ujitjen në Anën e Malit? Rrjeti i ujitjes është tërësisht jashtë funksionit, prej mëse 30 vitesh. Jemi përmytur në vitin 2010-2011, jemi dëmshpërblyer. Ky shpërblim a ka qënë i mbështetur në ligj? Pse nuk vazhdohet të ndiqen të njëjtat procedura.
9. **Z.Vinçens Gocaj,** banor i fshatit Obot.
 - a. Është bërë pastrimi i Kanaleve përpara 2 viteve, është e nevojshme që të pastrohen më shpesh, të shikohet mundësia me e perserit edhe nje herë pastrami i këtyre kanaleve.
 - b. Në kanalet kolluese janë të mbjella disa shelgje të cilat duhen prerë.
 - c. Përsa i përket ndricimit, kemi nevojë që të shtrohet ndriçimi rrugor në fshatin Obot.
 - d. Përsa i përket mbetjeve, Është e nevojshme të shohen disa konteiner tek Ura e Sagjisë
10. **Qytetar**
 - a. Të bëhet zgjerim i rrugës nga dogana e Muriqanit meqënëse është një segment rruge që nuk përballon trafikun gjatë periullës së sezonit turistik.

VI: RRJETI RRUGOR RURAL

1. Z.Arben Ceni

- a. Të shikohet mundësia e asfaltimit tek segmenti i kopshtit të fshatit Oblikë, sepse është një segment rruge që vlen për fëmijët.
- b. Përsa i përket investimeve në rrjetin rrugor u shprehen rekomandimet për të vijuar investimet në infrastrukturën rrugore nga banorët e Nj.Administrative Ana e Malit në fshatrat:
 - Muriqan – Goricë.
 - Lami- Rashkë.
 - Zona e pallateve Oblikë

- Alimataj
- Lagja e Re Oblikë
- Shtuf
- Dodaj

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Fisnik Lutfija.









BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2020-2024
ANA E MALIT

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	MOSHA VJEÇ	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Arben	Cerri	M		47	Oblike	vojte	Administratë
2	Farit	Pera	M		51			Postre e GJR
3	Megail	Shmider	M		60	Velinoj	penionist	
4	Benatbul	Mami	M		48	Oblike		
5	Mikela	Stenoj	M		54	Pelbart	Libri hieqnik	
6	Skender	Tajpi	M		61	Mungim	drejtor shkolle	
7	Xhemshije	Tajpi	F		58	Shkollor	edukatore shkolle	
8	Servet	Krye	M		58	Mungim	Kryepalok bregjen	
9	Fatonur	Prorri	M		61	Oblike	Kryepalok bregjen	
10	Ahmet	Sulejmi	M		72	Mungim	bluzer	
11	Talun	Shkollor	M		63	Oblike	Komitet	Ujegjellor
12	Alsid	Sadiku	M		33	Shkollor	Drejtore	Prerimane Publike
13	Mufarret	Pes	F		55	Oblike	Postre	Shkolle shkolle

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2020-2024
ANA E MALIT

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	MOSHA VJEÇ	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
1	ANDRANA	Andri	F	52	52	SHKODËR	MESUES	MBAJES
2	NERSADA	Mandisa	F	35		SHKODËR	Sociologe	Z. Punesj
3	BLERIN	DIMNAKU	M	32	32	OBLIKE	MESUESI	PISHERSHTI
4	Berlani	Felcaj	M		64	Shkoder	Agronomy	Arb.ije.
5	Abdyll	Harke	M	60		Hullveg.	Z. P. Met.	14. A. Met.
6	Sual	Soker	M	24		Oblike	P. GjendjeGjire Ni.ND.	Arre MOCIT
7	Faton	Shafa	M	35		Ob.Che	Informim.	ASH OBLIKE
8	Ali	Selima	M	55	55	Oblike	Shkoder "GELIKUOT"	
9	Atlut	Shkumbay	M	46	46	OBULIC		
10	EURIN	Hoxhaj	M	47		SHKODER	ZURIST	BET
11	Almet	Sulmu	M	67	67	Novilva	Fermer	Fermer
12	Serret	Julio	M	58	58	Keship	Shqip	Shqip
13	Orbaniq	Thandrea	M	68		Arre MOCIT	Pun.	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2020-2024
ANA E MALIT

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	MOSHA VJEÇ	VENDBANIMI (FSHATI)	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Vincenc	Çerçez	M	M	60	Qelës	Ypërfytyrës	Anca Melet
2	Arta	Mirka	F	-	25	Shkodër	brejtoria	Shushineve Sarda
3	Hatej	Kolosa	M	-	-	-	D. Mjedist	Lebere dhe Palmira, Ujare
4	Behar	Donici	M	-	-	Shkodër	Spjegues	B. Shushineve
5	Haron	Kacina	M	-	43	Ohër	Inspektor	Bytyeri
6	Spota	Devedele	F	-	41	Shkodër	Deputet	-
7	Samir	Shkupi	F	-	58	Shkodër	Deputet	K.R. Shkupi

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____